



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:195984
Datë: 18.03.2024
Numri i dokumentit: 05464219

C.nr.1419/22

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Blerina KURTAJ, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve A.D., me vendbanim në Istog dhe L.S., nga fshati..., Komuna Gjakovë të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ilir Rogova, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e inflacionit vjetor, vlera e kontestit 3,387.92 Euro, jashtë seance me datë 27 shkurt 2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve A.D., me vendbanim në Istog dhe L.S., nga fshati ..., Komuna Gjakovë dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, paditësve të iu paguajë:

- Paditëses A.D., në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit për periudhën kohore nga data 01.09.2019 e deri me datë 30.11.2022, shumën prej 804.20-€ (tetëqind e katër euro, e njëzetë cent).
- Paditësit L.S., në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit për periudhën kohore nga data 01.09.2019 e deri me datë 30.11.2022, shumën prej 461.66-€ (katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë euro, e gjashtëdhjetë e gjashtë cent).

Të gjitha shumat e lartcekura, detyrohet e paditura që të i paguajë me kamatë ligjore prej 8% në vit për secilën paditëse, e cila do të llogaritet nga data 21.09.2022 (data e paraqitjes së padisë), e

deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

II. REFUZOHET e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses A.D., mbi shumat e aprovuara sikurse në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar dhe atë në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit, në shumën prej nga 889.76-€, ndërsa për paditësin L.S., REFUZOHET e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, mbi shumat e aprovuara sikurse në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar dhe atë në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit, në shumën prej nga 1,232.30-€.

III. KONSTATOHET e tërhequr padia e paditësve A.D., dhe L.S., ndaj të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, në lidhje me kërkesën e pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit për periudhën kohore prej datës 17.04.2017 deri me datë 01.09.2019.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëseve të iu paguajë shumën prej 332.00.-€ (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë euro) në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësit A.D., me vendbanim në Istog dhe L.S., nga fshati ..., Komuna Gjakovë, në këtë gjykatë me datë 21.09.2022, përmes të autorizuarit të tyre Ilir Rogova, avokat në Gjakovë, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se paditësja A.D., është e punësuar, në Institucionin Arsimor “...” në fshatin ..., Komuna Gjakovë, ndërsa paditësi L.S., është i punësuar në Institucionin Arsimor “...”, në fshatin ..., Komuna Gjakovë. Në bazë të nenit 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e paditura ka për obligim që për çdo vit të përcjellë shkallën e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë të paditëseve. Meqë e paditura nuk e ka përbushur këtë detyrim, paditëset kanë paraqitur padi përmes të cilës kanë kërkuar që të i kompensohet diferenca e inflacionit në pagë, me kamatë ligjore si dhe i kanë kërkuar edhe shpenzimet procedurale. I autorizuari i paditëseve përmes parashtresës së datës 01.06.2023 ka precizuar kërkesëpadinë duke kërkuar nga gjykata që ta detyroi të paditurën që në emër të kompensimit të diferencës së

inflacionit në pagë nga data 01.09.2019 deri me datë 30.11.2022 paditëses A.D., nga Gjakova të ia paguajë shumën prej 1,693.96 Euro, ndërsa paditësit L.S., nga fshati ... Komuna Gjakovë që në emër të kompensimit të diferencës së inflacionit në pagë nga data 01.09.2019 deri me datë 30.11.2022 të ia paguajë shumën prej 1,693.96 Euro dhe kanë kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 15.03.2023, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsytimin se ky kompensim paditëseve nuk i takon as me kontratën e punës, e gjithashtu as me Ligjin e Punës. Sa i përket Kontratës Kolektive ka konsideruar se e njëjta është në kundërshtim me Ligjin e Punës, pasi që Komuna e Gjakovës nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit si dhe nuk ka buxhet të mjaftueshëm për pagesën e këtyre mjeteve. Tutje ka shtuar se paditëseve nuk i takon drejta e kompensimit të inflacionit pasi që në rast të shfaqjes së tij nuk godet vetëm një sektor të punësuarve si në rastin konkret sektorin e arsimit, por e godet tërë aparatit shtetëror. Ka konsideruar se në rastin konkret ka po ashtu parashkrim të kërkesës në të holla, andaj i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëseve ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të padisë, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditëses është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqës të paraqitura me padi, precizim të padisë dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontratat e punës për paditëset të lëshuara nga Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, vërtetohet fakti se paditësja A.D., është në marrëdhënie pune tek e paditura në Institucionin Arsimor “...” në fshatin ... Komuna Gjakovë, si mësimdhënëse e lëndëve Histori-Ed. Qytetare, ndërsa paditësi L.S., është në marrëdhënie pune tek e paditura në Institucionin Arsimor “...”, në fshatin Komuna Gjakovë. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses A.D., për periudhën 2019-2022 ka qenë në shumën prej 421.00 euro, kurse paditësi L.S., për periudhën 2019-2022 ka qenë në shumën prej 241.68 (koeficient 4/1). Po ashtu, gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit i publikuar nga Agjencia e

Statistikave të Kosovës, ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4%, ndërsa për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Provave të lartcekura gjykata iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021 e cila ka qenë në fuqi deri me datë 21.11.2022, ku në mënyrë identike në nenin 35 par.10 kanë përcaktuar se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëseve të lartcekura i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që një dispozitë e tillë është e karakterit imperativ dhe si e tillë do të duhej që shkalla e inflacionit të llogaritet në pagë, marrë parasysh që nga lista e pagave që gjendet në shkresat e lëndës, nuk rezulton që një pagesë e tillë është kryer nga e paditura.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata vendosi duke pasur parasysh të dhënat e nxjerra nga Enti i Statistikave të Kosovës sa i përket shkallës mesatare vjetore të inflacionit, përkatësisht ngritjes zingjyrore të inflacionit ndër vite dhe atë duke filluar llogaritjen nga viti 2019 deri në vitin 2022 (brenda kërkesës së paditëse) sipas përlllogaritjes si në vijim, për paditësen A.D.,

- Për periudhën Shtator-Dhjetor 2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, andaj duke e llogaritur në pagën bazë të paditëseve, e cila në vitin 2019 ka qenë 421.00 euro, i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditëse për periudhën kohore 4 mujore në total të jetë 45.47 euro, apo 11.37 euro për muaj ($421 * 2.7\% * 4 = 45.47$).

- Për periudhën Janar-Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, andaj duke e llogaritur pagën bazë të paditëseve sipas shtimit dinarik e cila në vitin 2020 do të duhej të ishte 432.37 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditëse për periudhën kohore 12 mujore në total të jetë 10.38 euro, apo 0.86 euro për muaj ($432.37 * 0.2\% * 12 = 10.38$),
- Për periudhën Janar-Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, andaj duke e llogaritur pagën bazë të paditëseve sipas shtimit dinarik e cila në vitin 2021 do të duhej të ishte 433.23 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditëse, për periudhën kohore 12 mujore në total të jetë 176.76 euro, apo 14.73 euro për muaj ($433.73 * 3.4\% * 12 = 176.76$).
- Për periudhën Janar-Nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, andaj duke e llogaritur pagën e paditësve sipas shtimit dinarik e cila në vitin 2022 do të duhej të ishte 447.96 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditëse për periudhën 11 mujore në total të jetë 571.60 euro, apo 51.96 euro për muaj ($447.96 * 11.6\% * 11 = 571.60$).

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata vendosi duke pasur parasysh të dhënat e nxjerra nga Enti i Statistikave të Kosovës sa i përket shkallës mesatare vjetore të inflacionit, përkatësisht ngritjes zingjyrore të inflacionit ndër vite dhe atë duke filluar llogaritjen nga viti 2019 deri në vitin 2022 (*brenda kërkesës së paditësit*) sipas përlllogaritjes si në vijim, për paditësin L.S.,

- Për periudhën Shtator-Dhjetor 2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, andaj duke e llogaritur në pagën bazë të paditësve, e cila në vitin 2019 ka qenë 241.68 euro, i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditëse për periudhën kohore 4 mujore në total të jetë 26.10 euro, apo 6.53 euro për muaj ($241.68 * 2.7\% * 4 = 26.10$).
- Për periudhën Janar-Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, andaj duke e llogaritur pagën bazë të paditësve sipas shtimit dinarik e cila në vitin 2020 do të duhej të ishte 248.21 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur

të futej në pagën bazë për secilin paditës për periudhën kohore 12 mujore në total të jetë 5.96 euro, apo 0.50 euro për muaj ($248.21 \cdot 0.2\% \cdot 12 = 5.96$),

- Për periudhën Janar-Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, andaj duke e llogaritur pagën bazë të paditësve sipas shtimit dinarik e cila në vitin 2021 do të duhej të ishte 248.70 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës, për periudhën kohore 12 mujore në total të jetë 101.47 euro, apo 8.46 euro për muaj ($248.70 \cdot 3.4\% \cdot 12 = 101.47$).
- Për periudhën Janar-Nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, andaj duke e llogaritur pagën e paditësve sipas shtimit dinarik e cila në vitin 2022 do të duhej të ishte 257.16 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës për periudhën 11 mujore në total të jetë 328.13 euro, apo 29.83 euro për muaj ($257.16 \cdot 11.6\% \cdot 11 = 328.13$).

Duke qenë se mes palëve nuk është kontestuese gjendja faktike përkatësisht se paditëset janë të punësuar tek e paditura dhe se në periudhën nga data 21.09.2019 deri me datë 30.11.2022 në pagën e paditësve nuk është përfshirë edhe shkalla e caktuar e inflacionit, të cilat fakte nuk i ka kontestuar as e paditura në përgjigjen në padi, edhe përkundër faktit se e njëjta e ka kundërshtuar kërkesëpadinë, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, për çka vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit mbi bazën e inflacionit, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadisë rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila bazohet në Ligjin nr.03/L-212 të Punës. Ndërsa sa i përket pretendimit se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate, një pretendim të tillë e refuzoi për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit është e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, andaj

prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditëseve dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditëset.

Pretendimin tjetër të paditurës lidhur me atë se inflacioni godet tërë aparatit shtetëror e jo vetëm sektorin e arsimit, gjykata e konsideron si të parëndësishëm, për arsye se çështja e përfshirjes së inflacionit në pagën e punëtorëve të arsimit është e rregulluar me KKAK, andaj është irelevante se kush goditet nga inflacioni, për aq kohë sa e drejta e paditëseve për ta kërkuar këtë kriter të kompensimit rrjedh nga dispozitat e kontratës kolektive të lartcekur.

Sa i përket pretendimit të dhënë në përgjigje në padi se në rastin në fjalë kemi parashkrim të kërkesës në tërësi, gjykata e refuzoi si të pabazuar, për arsye se konform nenit 87 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e që në rastin konkret paditësja ka kërkuar që të i kompensohet pagesa e inflacionit në pagë për periudhën kohore prej datës 21.09.2019 e deri me datë 30.11.2022 ndërsa padinë e ka paraqitur me datë 21.09.2022, pra brenda afatit prej tre viteve nga kur ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Sa i përket pjesës refuzuese paditësen A.D., respektivisht shumës në lartësi prej 889.76-€, ndërsa për paditësin L.S., respektivisht shumës prej nga 1,232.30-€, gjykata të njëjtën e refuzoi për shkak se paditëset as me padi, as në precizimin e padisë nuk ka prezantuar prova materiale për të vërtetuar këtë lartësi të kërkesës, sipas detyrimit të përcaktuar me nenin 7 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) ku është paraparë se *“palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. E për më tepër, gjykata përllogaritjen e përfshirjes së inflacionit në pagën bazë e ka filluar nga viti 2019, duke shtuar normën e inflacionit vit për vit deri në vitin 2022 (*shtimi dinarik*), për çka rezultoi se pjesa e kërkesëpadisë përtej shumës së aprovuar është e pabazuar, andaj gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se edhe në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar

se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se “Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, meqenëse i autorizuari i paditëseve me parashtrësën mbi precizimin e kërkesëpadiës të datës 01.06.2023 është tërhequr nga padia për kompensimin e ndryshimit në të ardhura mujore për paditësit .A.d., dhe L.S., për periudhën nga data 17.04.2017 deri me datë 01.09.2019, andaj gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 261 par.2 të LPK-së.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale si në pikën IV të dispozitivit, gjykata e mori sipas nenit 449 dhe 452 të LPK-së, me ç’rast paditësve iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 332.00.€. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00.-€, (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 156.00.-€, e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17), si dhe për përpilimin e parashtrësës për precizimin e padisë të datës 25.09.2023 në shumën prej 156.00.-€.

Nga të lartcekurat, gjykata bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1419/22, datë 18 mars 2024

Gj y q t a r j a,
Blerina KURTAJ

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.

Numri i lëndës: 2022:195984
Datë: 18.03.2024
Numri i dokumentit: 05464219